



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr.Regj.Them. 236 (00470)  
Datë 25.08.2022

Nr. Vendimi 127  
Datë 26.10.2022

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër i përbërë nga gjyqtarët:

**FUAT VJERDHA** - **Relator**  
**TONIN STERKAJ** - **Anëtar**  
**VALBONA VATA** - **Anëtare**

me sekretare seance **Remila Mema** më datë **26.10.2022**, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim ankimin e paraqitur për çështjen civile që i përket:

**KËRKUES:**

**Mark Molla**, i biri i Ndoc dhe i Lule, i ditëlindjes 20.05.1961, lindur në fshatin Malagji, Temal dhe banues në Shkodër, Rruga “Qafa e Agrit”, pallati nr. 7.

**PERSON I TRETË:**

1. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “UKSH” sha, me seli në Shkodër, rruga “13 dhjetori”;
2. Bardh Spahia, me adresë njoftimi Bashkia Shkodër
3. Avokatura e Shtetit Shkodër
4. Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesave (ILDKPKI), me adresë: Rruga Reshit Collaku, Tiranë.
5. Këshilli i Ministrave, Tiranë
6. Qendra Kombëtare e Regjistrimit
7. Bashkia Shkodër
8. Prefekti i Qarkut Shkodër
9. Voltana Ademi, L. Arra e Madhe Shkodër
10. Arvid Bushati, me adresë njoftimi Bashkia Shkodër
11. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër

**OBJEKTI:**

Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e vendimit nr.16, datë 18.07.2022, vendimit nr.17, date 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetës kanalizime Shkodër sh.a deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, duke detyruar të paditurin që të mos kërkojë regjistrimin e këtyre vendimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri në zgjidhjen me vendim përfundimtar të këtij konflikti për padinë e paraqitur me datë 19.07.2022.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 202 i K.Pr.Civile Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008



“Per tregtarët dhe shoqërite tregtare” Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për diskriminimin”, neni 15, 38 e vijues Ligjir nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” Ligji 139/2015 “Për qeverisjen vendore” Kodi Civil Kodi i Punës

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 16 (2984), datë 19.07.2022 ka vendosur:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e vendimit nr.16, datë 18.07.2022, vendimit nr.17, datë 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjellës kanalizime Shkodër sh.a deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, të vendimit që do zgjidhë çështjen civile të regjistruar mbi bazën e kërkesë padisë, që i është bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Një kopje e shkurtuar e këtij vendimi ti njoftohet menjëherë palëve ndërgjyqëse të gjykuara në mungesë të tyre;
4. Shpenzimet gjyqësore mbeten siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga ndërgjyqësit, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi i tretë Bashkia Shkodër, duke parashtruar këto shkaqe për ankimin:**

1.Z.Ymeri në këtë vendimarrje është në kushtet e konfliktit të interesit me z.Mark Molla. Sqarohet se pranë UKSH Shkodër, z.Molla ka emëruar z.Pëllumb Prençi me detyrë Inspektor Taskforce pranë UKSH,sh.a, me anë të urdhërit nr.203, datë 15.06.2022. Z.Prençi është kunati i z.Andri Ymeri (bashkëshorti i motrës), në të tilla kushte vendimi nr.16(2984), datë 19.07.2022, është dhënë nga gjykata nën ndikimin e kushteve subjektive, që bie ndesh me parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë së gjykatës si dhe nenit 72 të Kodit të Proçedurës Civile.

2. Pala paditëse nuk ka gëzon legjitimitim aktiv për të paraqitur kërkesën objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, pasi vendimet objekt i këtij procesi, të cilët kundërshtohen, janë marrë nga organi kompetent, brenda tagrave ligjore dhe tërësisht i mbështetur në lëgjislacionin në fuqi, konkretisht ligji nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ i ndryshuar,ligji nr.9901,datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar;VKM nr.63,datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, VKB Shkodër nr.28, datë 01.06.2016 “Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare Ujësjellës–Kanalizime Shkodërsh.a”.

Me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime Shkodër, sh.a nr.16, datë 18.07.2022 “Për lirimimin nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a është vendosur:

-Lirimini nga detyra të z.Mark Molla,administrator i shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a',për shkak të mbarimit të mandatit sipas nenit 18, pika 5 të VKB Shkodër nr.28, datë 01.06.2016.

-Ngarkohet z.Mark Molla të bëj dorëzimet sipas ligjit.

-Ngarkohet z.Mark Molla dhe Shoqëria aksionare 'Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a' për zbatimin e këtij vendimi.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dhe me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime nr.17, datë 18.07.2022 "Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a'" është vendosur:

-Emërimin e z.Arvit Bushati , administrator të shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a' me afat 3 vjeçar.

-Paga e administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a' është në vlerën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.

-Ngarkohet Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a për regjistrimin e këtij e vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas përcaktimeve të nenit 18 ,pika 7, germa 'i' të VKB Shkodër nr.28,datë 01.06.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare Ujësjellës-Kanalizime Shkodër, sh.a".

-Ngarkohet Administratori dhe Shoqëria aksio

nare 'Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a' për zbatimin e këtij vendimi.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme nr.16, datë 18.07.2022 "Për lirimini nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a",ne pikën 4 citon 'Ky vendim hyn në fuqi menjëherë'.Vendimi i Asamblesë së

Përgjithshme nr.17, datë 18.07.2022 "Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjellës - Kanalizime Shkodër sh.a", në pikë 5 citon : 'Ky vendim hyn në fuqi menjëherë'.

Në të tilla Kushte këto vendimarrjet të Asamblesë së Përgjithshme nr.16 dhe nr.17 të datës 18.07.2022 i kanë filluar efektet e tyre financiare dhe juridike në datë 18.07.2022. Ndërkohë që vendimi i gjykatës, me anë të cilit është vendosur pranimi i sigurimit të padisë, është i një date të mëvonshme konkretisht datë 19.07.2022, e në të tilla kushte kjo vendimarrje e gjykatës, nuk ka afekt

prarpaveprues, pasi vendimet 16, 17 i kanë sjellë pasojat financiare dhe juridike të synuara.

Kërkesa për sigurimin e padisë ka si qëllim shmangien e pasojave që mund të pësojë pala kerkuese deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata dhe me anë të saj nuk synohet arritja e një rezultati përfundimtar, apo i njëjti rezultat si gjykimi i themelit, por synon të garantojë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet në rrjedhën normale të procesit gjyqësor, deri sa gjykata të të disponojë mbi themelin e mosmarrëveshjes. Me anë të sigurimit të padisë synohet të bëhet një vlerësim paraprak , sipërfaqësor i fakteve dhe provave të paraqitura nga paditësi, nëse mund të ekzistojë mundësia e ardhjes të një dëmi të rëndë e të parikuperueshëm për palën paditëse. Në të tilla kushte vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile neni 202 e vijues.

4. Bëjme me dije për gjykatën se vendimet objekt gjykimi, nuk kanë arritur të rregjistrohet/publikohen në QKB nga ana e administratortit, z.Arvit Bushati, pasi është fakt i njohur botërisht që në data 18-19.07.2022 portalet qeveritare , përfshirë edhe rregjistrimet/publikimet në QKB nuk kanë funksionuar.Me normalizimi dhe rregullimin e situatës, këto vendime do të rregjistrohen sipas ligjit.

5. Pala kerkuese, z.Mark Molla nuk legjitimohet për kërkimin e sigurimit të padisë për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.17, datë 18.07.2022 “Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a’”, pasi ky vendim i drejtohet dhe sjellë pasoja për një palë të tretë, dhe jo direkt për z.Molla.

6. Duke patur parasysh kompleksitetin e marrëdhënies vlerësojmë se gjykata nuk ka vepruar drejtë në gjykimin e çështjes në Dhomë Këshillimi pa praninë e palëve , duke mos kërkuar as dhe një provë apo qëndrim nga Asambleja e Përgjithshme në keto kushte duke ju mohuar e drejta e kontradiktoritetit palës së paditur në këtë gjykim, referuar nenit 18 të K.Pr. Civile. Referuar dhe nenit 205 të Kodit të Procedurës Civile, kjo kërkesë duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata në praninë e palëve. Ky fakt do ta ndihmonte gjykatën zgjidhjen e çështjes nepërmjet një gjykimi më të drejtë dhe të paanshëm.

7. Pala kerkuese, z.Molla pretendon se vendimi nr.16, datë 18.07.2022 “Për lirimin nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a’” është marrë në një moment kur kjo palë ka qënë me raportë mjekësore. Bëjme me dije për gjykatën se pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sha, nuk ka të administruar/protokolluar asnjë raport mjekësore për këtë pale në datat 18-19.07.2022. Përkundrazi, pala kerkuese rezulton që në datë 18.07.2022 të ketë qënë prezent në ambjentet e Ndërmarrjes Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a, ku ka marrë personalisht, dorazi nga ana e sekretarisë vendimet objekt i këtij gjykimi. Në kushtet kur kjo palë pretendon të jetë jo në gjëndje të mirë

shëndetësore, nuk justifikohet as nga faktin që në datë 19.07.2022 ka hartuar, dhe depozituar personalisht pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër kërkesën e objekt gjykimi, pasi kjo kërkesëpadi rezultoi të jetë e nënshkruar prej tij, dhe jo nga ana e ndonjë përfaqësuesi.

8. Nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, me anë të vendimit nr.16 (2984), datë 19.07.2022 krijohet një situatë kaotike për institucionin, pasi z. Molla i ka mbaruara

mandati në datë 30.05.2022 sipas vendimit nr.05, datë 30.05.2019. Gjithashtu me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër të datës 18.07.2022, është ligjësuar procedura e mbarimit të madatit z.Molla dhe vijimi i procedurës të mërërimit të administratorit të ri nga ana e Asamblesë e Përgjithshme në kuptim të Statutit të UKSH , neni 18.

**Në përfundim të ankimit ka kërkuar:** Pranimin e kërkesës ankimore dhe prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 16 (2984), datë 19.07.2022, dhe rrezimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

**Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi i tretë Asambleja e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sha, duke parashtruar këto shkaqe për ankimin:**

Pala paditëse nuk ka gëzon legjitimim aktiv për të paraqitur kërkesën objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, pasi vendimet objekt i këtij procesi, të cilët kundërshtohen, janë marrë nga organi kompetent, brenda tagrave ligjore dhe tërësisht i mbështetur në lëgjislacionin në fuqi, konkretisht ligji nr. 139/2015 ‘Për vetëqeversijen vendore’ i ndryshuar, ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar; VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, VKB Shkodër nr.28, datë 01.06.2016 “Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare Ujësjetllës–Kanalizime Shkodërsh.a”.

Me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, sh.a nr.16, datë 18.07.2022 “Për lirim nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a është vendosur:

-Lirim nga detyra të z.Mark Molla, administrator i shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a’, për shkak të mbarimit të mandatit sipas nenit 18, pika 5 të VKB Shkodër nr.28, datë 01.06.2016.

-Ngarkohet z.Mark Molla të bëjë dorëzimet sipas ligjit.

-Ngarkohet z.Mark Molla dhe Shoqëria aksionare ‘Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a’ për zbatimin e këtij vendimi.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dhe me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime nr.17, datë 18.07.2022 “Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a” është vendosur:

-Emërimin e z.Arvit Bushati , administrator të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a’ me afat 3 vjeçar.

-Paga e administratorit të shoqërisë aksionare ‘Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a’ është në vlerën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.

-Ngarkohet Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a për regjistrimin e këtij e vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas përcaktimeve të nenit 18 ,pika

7, germa 'i' të VKB Shkodër nr.28, datë 01.06.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër, sh.a".

-Ngarkohet Administratori dhe Shoqëria aksionare 'Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a' për zbatimin e këtij vendimi.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

2. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme nr.16, datë 18.07.2022 "Për lirim nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a", ne piken 4 citon 'Ky vendim hyn në fuqi menjëherë', Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme nr.17, datë 18.07.2022 "Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a", në pikë 5 citon : 'Ky vendim hyn në fuqi menjëherë'.

Në të tilla Kushte këto vendimarrjet të Asamblesë së Përgjithshme nr.16 dhe nr.17 të datës 18.07.2022 i kanë filluar efektet e tyre financiare dhe juridike në datë 18.07.2022. Ndërkohë që vendimi i gjykatës, me anë të cilit është vendosur pranimi i sigurimit të padisë, është i një date të mëvonshme konkretisht datë 19.07.2022, e në të tilla kushte kjo vendimrraje e gjykatës, nuk ka afekt prarpaveprues, pasi vendimet 16, 17 i kanë sjellë pasojat financiare dhe juridike të synuara.

Kërkesa për sigurimin e padisë ka si qëllim shmangien e pasojave që mund të pësojë pala kerkuese deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata dhe me anë të saj nuk synohet arritja e një rezultati përfundimtar, apo i njëjti rezultat si gjykimi i themelit, por synon të garantojë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet në rrjedhën normale të procesit gjyqësor, deri sa gjykata të të disponojë mbi themelin e mosmarrëveshjes. Me anë të sigurimit të padisë synohet të bëhet një vlerësim paraprak , sipërfaqësor i fakteve dhe provave të paraqitura nga paditësi, nëse mund të ekzistojë mundësia e ardhjes të një dëmi të rëndë e të parikuperueshëm për palën paditëse. Në të tilla kushte vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile neni 202 e vijues.

3. Bëjme me dije për gjykatën se vendimet objekt gjykimi, nuk kanë arritur të rregjistrohet/publikohen në QKB nga ana e administratorit, z.Arvit Bushati, pasi është fakt i njohur botërisht që në data 18-19.07.2022 portalet qeveritare , përfshirë edhe rregjistrimet/publikimet në QKB nuk kanë funksionuar.Me normalizimi dhe rregullimin e situatës, këto vendime do të rregjistrohen sipas ligjit.

4. Pala paditëse, z.Mark Molla nuk legjitimohet për kërkimin e sigurimit të padisë për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.17, datë 18.07.2022 "Për emërimin e administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a", pasi ky vendim i drejtohet dhe sjellë pasoja për një palë të tretë, dhe jo direkt për z.Molla.

5. Duke patur parasysh kompleksitetin e marrëdhënies vlerësojmë se gjykata nuk ka vepruar drejtë në gjykimin e çështjes në dhomë Këshillimi pa praninë e palëve , duke mos kërkuar as dhe një provë apo qëndrim nga Asambleja e Përgjithshme në keto kushte duke ju mohuar e drejta e kontradiktoritetit palës së paditur në këtë gjykim, referuar nenit 18 të K.Pr. Civile. Referuar dhe nenit 205 të Kodit të Procedurës Civile, kjo kërkesë duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata në praninë e palëve. Ky fakt do ta ndihmonte gjykatën zgjidhjen e çështjes nepërmjet një gjykimi më të drejtë dhe të paanshëm.

6. Pala kerkuese, z.Molla pretendon se vendimi nr.16, datë 18.07.2022 "Për lirim nga detyra të administratorit të shoqërisë aksionare 'Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a" është marrë në një moment kur kjo palë ka qënë me raportë mjekësore. Bëjme me dije për gjykatën se pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Ndërrmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Shkodërt sha, nuk ka të administruar/protokolluar asnjë raport mjekësore për këtë palë. Përkundrazi, pala kerkuese rezulton që në datë 18 të ketë qënë prezent në ambientet e Ndërrmarrjes Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër sh.a, ku ka marrë personalisht, dorazi nga ana e sekretarisë vendimet objekt i këtij gjykimi. Në kushtet kur kjo palë pretendon të jetë jo në gjëndje të mirë shëndetësore, nuk justifikohet as

nga faktin që në datë 19.07.2022 ka hartuar, dhe depozituar personalisht pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër kërkesën e objekt gjykimi, pasi kjo kërkesëpadi rezulton të jetë e nënshkruar prej tij, dhe jo nga ana e ndonjë përfaqësuesi.

**Në përfundim të ankimit ka kërkuar:** Pranimin e kërkesës ankimore dhe prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 16 (2984), datë 19.07.2022, dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR,**

pasi shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi

### **VËREN**

Vendimi nr. 16 (2984), datë 19.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me të cilin është pranuar kërkesa e kërkuarit Mark Molla për sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e vendimit nr.16, datë 18.07.2022, vendimit nr.17, datë 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës kanalizime Shkodër sh.a., duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesa, si një kërkesë e pambështetur në ligj.

Nga shqyrtimi i çështjes në shkallë të parë të gjykimit ka rezultuar se kërkuari Mark Molla me datën 19.07.2022 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për sigurimin e padisë, duke vendosur pezullimin e vendimit nr. 16, datë 18.07.2022 dhe vendimit nr 17, datë 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata, duke detyruar të paditurin që të mos kërkojë rregjistrimin e këtyre vendimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri në zgjidhjen me vendim përfundimtar të këtij konflikti për padinë e paraqitur me datë 19.07.2022.

Kërkuari ka shpjeguar se ka ushtruar detyrën e Administratorit të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. që nga data 13.11.2015. Gjatë këtyre viteve shoqëria, në drejtimin e tij ka përmirësuar ndjeshëm performancën dhe treguesit e saj, fakt ky i pasqyruar në vlerësimet me sistemin e pikëzimeve të marra nga qeveria, si dhe përpjekja dhe mbështetja që kanë treguar donatorë të huaj në lidhje me këtë shoqëri.

Në datën 18.07.2022 ai ka marrë njoftim, nga punonjësit e institucionit ku punon për vendimet me numër 16 dhe 17 të lëshuara nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.

Me vendimin me numër 16, datë 18.07.2022 të kryetarit Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Bardh Spahia është vendosur:

1. Lirimin nga detyra e z. Mark Molla, administrator i shoqërisë aksionare "Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a." për shkak të mbarimit të mandatit, sipas nenit 18, pika 5 e V.K.B. Shkodër me numër 28, datë 01.06.2016.
2. Ngarkohet z. Mark Molla të bëjë dorëzimet përkatëse në bazë të ligjit.
3. Ngarkohet z. Mark Molla dhe Shoqëria Aksionare "Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a." për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ndërsa me vendimin me numër 17, datë 18.07.2022 të kryetarit Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Bardh Spahia është vendosur:

1. Emërimin e z. Arvid Bushati administrator të shoqërisë aksionare Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. me afat 3 vjeçar.
2. Paga e administratorit të shoqërisë aksionare Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. është në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë aksionare Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. për rregjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas përcaktimeve të nenit

18, pika 7 e V.K.B. Shkodër nr 28, datë 01.06.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionare Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a."

4. Ngarkohet Administratori dhe Shoqëria Aksionare "Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a." për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Duke mos u pajtuar me këto vendime, kërkuesi Mark Molla ka paraqitur kërkesëpadi në datën 19.07.2022 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me palë: Paditës: Mark Molla I paditur: Asambleja e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a., etj. Objekt: Pavlefshmërinë e vendimeve me numër 16 dhe 17 datë 18.07.2022 të lëshuara nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.

Për shkak të pretendimeve që kërkuesi ka për paligjshmërinë të vendimeve me numër 16 dhe 17 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a. ai i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për sigurimin e objektit të padisë, duke pretenduar:

1) Vendimet numër 16 dhe 17 datë 18.07.2022 të lëshuara nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a. janë nxjerrë në kundërshtim të hapur hapur me ligjin, pasi as Asambleja dhe as kryetari i saj nuk kanë kompetencë për emërimin dhe shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalime Shkodër sh.a, kjo bazuar në nenet 154, 157, 158 të ligjit me numër 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të drejta këto që në bazë të këtyre dispozitave i takojnë vetëm Këshillit të Administrimit. Duke u bazuar në faktin se këto vendime janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, sipas kërkuesit ato janë absolutisht të pavlefshme.

2) Vendimi me numër 16, datë 18.07.2022 i Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka dalë për shkaqe diskriminuese, të cilat kanë ardhur për shkak të mosmbështetjes së z. Bardh Spahia gjatë garës si Kryetar i Bashkisë Shkodër. Ky pretendim i kërkuesit bazohet krahas pretendimit të parë edhe në faktin se vendimi në fjalë nuk është i arsyetuar në lidhje me shkaqet e lirimimit nga detyra të kërkuesit.

3) Vendimi me numër 16, datë 18.07.2022 i Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a ka ardhur si rrjedhojë e kundërpërgjigjes së kërkuesit për kundërshtimin e vendimit me numër 09, datë 16.05.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a., të nxjerrë nga kryetari i saj Bardh Spahia. Me këtë vendim të fundit Kryetari i Asamblesë së UKSH revokonte vendimin me numër 05, datë 24.03.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a për riemërimin e kërkuesit Mark Molla si Administrator i UKSH. Kundërshtimi i vendimit numër 09 është bërë nga kërkuesi gjyqësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka depozituar kërkespadi për pavlefshmërinë absolute të këtij vendimi, e cila ende nuk ka një vendim përfundimtar nga kjo gjykatë.

4) Kërkuesi ka pretenduar se me Kryetarin e Asamblesë së UKSH sh.a. është në konflikt interesi për shkak të rrethanave të sipërcituara, të pohuara nga përfaqësuesi i palës së paditur/Asambleja e UKSH gjatë gjykimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë me të cilën kërkuesi ka kundërshtuar vendimin me numër 09, të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH. Bazuar në këtë konflikt interesi Kryetari i Asamblesë së UKSH sh.a. nuk duhet të merrte vendime në drejtim të kërkuesit, bazuar në Ligji nr 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" derisa kjo situatë konflikti interesi të zgjidhej me vendim përfundimtar të formës së prerë.

5) Vendimi me numër 16, datë 18.07.2022 i Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a bie ndesh me Kodin e Punës, pasi lirimi nga detyra i kërkuesit është bërë pa respektuar asnjë procedurë të përcaktuar në Kodin e Punës dhe në kohë të papërshtatshme, pasi ka qenë në kushtet e paaftësisë së përkohshme në punë, (nenet 141, 143, 144 e 147).

6) Si rrjedhojë e veprimeve të palës së paditur (Asamblesë së UKSH) kërkuesi pretendon se i janë shkaktuar dëm pasuror dhe jo pasuror.



7) Kërkuesi Mark Molla kërkon nga Gjykata të vendosë sigurimin e objektit të padisë në interes të mbrojtjes të të drejtave të tij dhe punonjësve të institucionit ku ai punon. Kjo për shkak se vonesa mund të sjellë pasoja të pariparueshme ndodhur në kushtet që pas publikimit të këtyre vendimeve në QKB kthimi i kërkuesit në punë bëhet i pamundur dhe në të njëjtën kohë ekziston rreziku potencial i largimeve të shumta nga puna në institucionin e drejtuar nga kërkuesi, si rrjedhojë e veprimeve të Kryetarit të Asamblesë së UKSH.

Bashkalidhur me kërkesën për sigurimin e padisë janë paraqitur:

- 1) Kërkespadi e datës 19.07.2022 me palë paditës Mark Molla, e paditur Asambleja e Përgjithshme e UKSH.
- 2) Ekstrakt historik i UKSH.
- 3) Vendimi me numër 16, datë 18.07.2022 i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a përfaqësuar nga Bardh Spahia.
- 4) Vendimi me numër 17, datë 18.07.2022 i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a përfaqësuar nga Bardh Spahia.
- 5) Raport për paaftësitë përkoshme në punë datë 18.07.2022 për shtetasin Mark Molla.
- 6) Informacion mbi çështjen, printim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nga e cila rezulton se me datën 20.05.2022 në këtë gjykatë është dorëzuar padia me objekt sigurimin e objektit të padisë duke vendosur pezullimin e aktit administrative vendim me numër 09, datë 16.05.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. deri në marrjen e vendimit formë të prerë nga gjykata. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit me numër 09, datë 16.05.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Palë: paditës Mark Molla, e paditur Asambleja e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.

Pasi ka shqyrtuar kërkesën në dhomë këshillimi, Gjykata ka pranuar kërkesën, duke arsyetuar si vijon:

*"Gjykata vlerëson se bazuar në pretendimet e kërkuesit/paditësit Mark Molla dhe aktet shkresore që i mbështesin këto pretendime, shkaku ligjor (causa pretendi) që ka motivuar paditësin për të investuar Gjykatën konsiston në ekzistencën e njëkohshme të dy nevojave ligjore të tyre, që janë: a) Mbrojtja e të drejtës për punësimin e tij. b) Nevoja për t'u mbrojtur nga ekzekutimi i vendimi të organit të shoqërisë ku punon kërkuesi, vendim i cili sipas kërkuesit është i paligjshëm dhe diskriminues. Duke çmuar ekzistencën e këtyre nevojave ligjore të kërkuesit/paditësit Mark Molla Gjykata vlerëson se për shkak të veprimtarisë të deritanishme, më karakter të vazhdueshëm të Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. në drejtim të kërkuesit ka arsye të bazuara të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit Mark Molla, nëse ky rezulton gjyqësor, mund të bëhet i pamundur ose i vështirë. Ky konkluzion i Gjykatës i referohet veçanarisht këtyre rrethanave: 1) Sjelljes së përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Bardh Spahia, që shfaqet në vendimarrje të përsëritura të cilat çenojnë të drejtat e punësimit të kërkuesit Mark Molla, përkatësit vendimet me numër 09, 16 dhe 17 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH. Kjo mënyrë sjellje e palës së paditur pasqyron rrezikun që ka kërkuesi/paditësi që vendimi gjyqësor, nëse ai rezulton gjyqësor, të bëhet i pamundur për t'u ekzekutuar apo ky ekzekutim të jetë i vështirë. 2) Faktit që pas publikimit në QKB të vendimeve me numër 16 dhe 17 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH fillon zbatimi i tyre dhe kthimi pas i këtyre vendimeve, edhe pas një procedure gjyqësore, mbart në vetvete rrezikun që ekzekutimi i vendimit gjyqësor për të cilin kërkuesi i është drejtuar gjykatës, të bëhet i pamundur për t'u ekzekutuar apo ky ekzekutim të jetë i vështirë. 3) Faktit që punësimi i Administratorit të UKSH është me afat 3 vjeçar, pra është një punësim me kohë të caktuar nënkupton faktin se*

koha që nevojitet për shqyrtimin në themel të të padisë së kërkuarit/paditësit Mark Molla, në shkallë të ndryshme të gjykimit, mund të jetë thujse apo më e gjatë se vetë kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës në cilësinë e administratorit, gjë që mund të passjellë humbjen e interesit të ligjshëm të tij të synuar përmes kësaj padie. Faqja 4 nga 9 Mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se duhet të pranojë kërkesën sigurimin e objektit të padisë të paraqitur nga kërkuari Mark Molla. Pranimi i kësaj kërkesë do të bëhet bazuar në parashikimet e nenit 206 të K.Pr.Civile, sipas të cilit: "Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit; b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata. Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Sekuestro nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen". Në vlerësimin e kërkesës për sigurimin e objektit të padisë të paraqitur nga kërkuari Mark Molla Gjykata në vlerësim të saj ka në konsideratë edhe legjislacionin material, që rregullon veprimtarinë e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime (Ligji me numër 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statutin e Shoqërisë UKSH sh.a.), si dhe legjislacionin i cili rregullon pretendimet e paditësit për trajtim diskriminues dhe në kushtet e konfliktit të interesit. Së pari, në vlerësimin e pretendimeve të kërkuarit për pavlefshmërinë absolute të vendimeve me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. Gjykata ka në konsideratë parashikimet e neneve 135, 154, etj të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 18 të Statutit të Shoqërisë UKSH, si dhe nenet 92 e vijues të K.Civil. Më konkretisht në nenin 135/2, pika "c" të ligjit me numër 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dispozitë të cilët referojnë vendimet në fjalë parashikohet: 1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të këtij ligji, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimit të shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme. 2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës e, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve; Bazuar në këtë dispozitë ligjore rezultojnë qartë se ndërsa Asambleja e Përgjithshme, si organi përfaqësues i një shoqërie anonime, ka kompetencë për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës këtë kompetencë nuk e ka për Administratorin e shoqërisë, pasi në asnjë prej funksioneve të Asamblesë nuk parashikohet e drejta për emërimin dhe shkarkimin e administratorit. Ndërkohë në nenin 18/5 i Statutit të UKSH të miratuar me vendimin me numër 28, datë 01.06.2016 të VKB Shkodër parashikohet: "Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratës midis asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë të vlersimeve pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar". Bazuar në këtë dispozitë të Statutit të UKSH edhe në të nuk përcaktohet e drejta e Asamblesë së Përgjithshme për emërimin dhe shkarkimin e administratorit të UKSH, por normohet mënyra e formalizimit të kontratës së punësimit të tij, gjë që do të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme, si përfaqësuese e shoqërisë. Ushtrimi i këtij tagri nga Asambleja e Përgjithshme nuk përfshin pasjen nga ajo të kompetencave të emërimit dhe shkaktimi të administratorit të UKSH. E drejta për emërimin e Administratorit të një shoqërie anonime, siç është edhe UKSH është e rregulluar në nenin 154 të ligjit me numër 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i cili parashikon: "Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: ...f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre". Pra e drejta për emërimin dhe Faqja 5 nga 9 shkarkimin e administratorëve në një shoqëri anonime, sic është UKSH i përket vetëm organit të kësaj shoqërie Këshilli Mbikëqyrës, organ ky i ndryshëm nga Asambleja e Përgjithshme. Parë në këtë këndvështrim vendimet me numër

16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH duket sikur janë nxjerrë nga ky organ në tejkalim të kompetencave të njohura me ligj. Aktet juridike me të cilat organi i kësaj shoqërie krijon të drejta dhe detyrime përbën një veprim juridik. Në nenin 79 të K.Civil parashikohet: "Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile." Si çdo veprim juridik këto akte duhet të hartohen jo vetëm në formën e përcaktuar në ligj dhe statut, por ato duhet të jenë edhe në përmbajtje në përputhje me parashikimet ligjore. Në nenin 92/1, pika "a" të K.Civil, parashikohet: Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; Vlersuar në këndvështrim të këtij arsytimi vendimet me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH duket sikur janë absolutisht të pavlefshme për shkak se vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Së dyti, duke vlerësuar procedurat e ndjekura nga pala e paditur në zgjidhjen e marrëdhënieve të punësimit më kërkuesin (lirim nga detyra), Gjykatës i krijohet dyshimi i arsyeshem se kjo procedurë mund të jetë në shkelje të parashikimeve të K.Punës, dhe konkretisht dispozitave të cilat rregullojnë marrëdhëniet e punësimit të administratorit, të cilat nuk rregullohen me ligj të veçantë apo statut. Konkretisht në këtë drejtim Gjykata ka në konsideratë parashikimet e neneve 144, 147, 149, 151 etj të K.Punës, të cilët parashikojnë: Neni 149 i K.Punës: "1. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. 2. Kur, mbas përfundimit të afatit të caktuar, kontrata zgjatet në heshtje tej këtij afati, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar. 3. Në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të caktuar, përpara përfundimit të afatit, zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 144 të këtij Kodi". Neni 144 i K.Punës: "1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të. 2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur. 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes. " Neni 147 i K.Punës: 1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paafësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. 2. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paafësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. Neni 151 i K.Punës: "1. Kur ndërmjet palëve kanë qenë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme me afat të caktuar, për jo më pak se tre vjet, mosripërtëritja e kontratës së fundit nga punëdhënësi vlerësohet si zgjidhje e kontratës me afat të pacaktuar. Kontratat me afat të caktuar ndërmjet të njëjtave palë do të konsiderohen si të njëpasnjëshme edhe në ato raste kur ka një ndërprerje të shkurtër, jo më shumë se tre muaj, ndërmjet mbarimit të një kontrate dhe lidhjes së kontratës tjetër. Faqja 6 nga 9 2. Kur kontrata lidhet për më shumë se 3 deri në 5 vjet, ajo mund të zgjidhet nga punëmarrësi pas 3 vjetësh. Në këtë rast afati i njoftimit është 2 muaj dhe zgjatet deri në fund të muajit të dytë. Kur kontrata lidhet për më shumë se 5 vjet, ajo mund të zgjidhet nga punëmarrësi pas 5 vjetësh. Në këtë rast afati i njoftimit është 3 muaj dhe zgjatet deri në fund të muajit të tretë." Vlersuar në këndvështrim të këtyre dispozitave vendimet me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH duket sikur janë absolutisht të pavlefshme për shkak se vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit konkretisht neneve 149, 144, 147, 151 etj të K.Punës. Së treti: Gjykata vlerëson se bazuar në rrethanat e paraqitura nga kërkuesi

Mark Molla në lidhje me marrëdhëniet e tij me përfaqësuesin e Asamblesë së Përgjithshme të UKSH, Bardh Spahia ekziston dyshimi i arsyeshëm që kërkuesi Mark Molla të ketë qenë objekt i trajtimit diskriminues dhe i viktimizimit të tij nga pala e paditur. Në ligjin me numër me numër 10221, datë 04.02.2010 "Për diskriminimin", neni 1 parashikohet: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër." Në nenin 3/1 të këtij ligji parashikohet: "1. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi." Në nenin 3, pika 2 të ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 "PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI" parashikohet: 2. "Diskriminim i drejtëpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji. Në nenin 3/8 të këtij ligji parashikohet: "8. Viktimizimi" është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë". Vlersuar në këndvështrim të këtyre dispozitave vendimet me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH duket sikur janë nxjerrë nga përfaqësuesi i Asamblesë së Përgjithshme të UKSH për shkak të diskriminimit të kërkuesit si rrjedhojë e bindjeve të tij politike, si dhe viktimizimit të tij për shkak të reagimit përkundrejt veprimtarisë administrative të Asamblesë së Përgjithshme shfaqur kjo me vendimin me numër 09, datë 16.05.2022. Duke patur në konsideratë parashikimet e këtij ligji Gjykata vlerëson se dhënia e masës së përkohshme të sigurimit të padisë është edhe në përputhje me parashikimet e nenit 15/2 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për diskriminimin" në të cilin parashikohet: "1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës". Gjykata vlerëson se bazuar në parashikimet e mësipërme kërkuesit Mark Molla, si çdo punëmarrës i cili pretendon diskriminimin në marrëdhëniet e punësimit nuk mund t'i ndërpriten marrëdhëniet e punësimit derisa punëdhënësi i tij apo gjykata të marrin një vendim për pretendimin e tij për trajtim diskriminues. Së katërti, në vlerësimin e pretendimeve të kërkuesit Mark Molla dhe veçanërisht duke patur në Faqja 7 nga 9 konsideratë konfliktin ekzistues gjyqësor që ekziston në mes tij dhe përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH në lidhje me vendimin e kësaj të fundit me numër 9, datë 16.05.2022 te Gjykata krijohen dyshime për mundësinë e ekzistencën së gjendjes së konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të ligjit nr 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike". Në nenin 1 të këtij ligji parashikohet: "Qëllimi i ligjit është garantimi i një vendimarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut, e të besimit ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta". Neni 3 parashikon: "Konflikt interesi është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interes privat, të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket se ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe

*përgjegjësi të tij publike.” Duke vlerësuar mundësinë e ekzistencës së kësaj gjendje të konfliktit të interesit, Gjykata çmon se përfaqësuesi i Asamblesë së Përgjithshme të UKSH Bardh Spahia duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e tij, qoftë edhe në dukje. Mosmarrja në konsideratë e kësaj gjendje nga ana e këtij të fundit nuk mund të mos efetojë vendimet me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 në drejtim të ligjshmërisë së tyre. Së pesti, Gjykata vlerëson se pranimit i kërkesës për sigurimin e objektit të padisë të paraqitur nga kërkuesi Mark Molla ka në themel të saj edhe shmangien e dëmeve pasurore dhe jo pasurore që mund të shkaktohen apo rëndohen më tej nga zbatimi i vendimeve me numër 16 dhe 17 të datës 18.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH. Kjo ndodhur në kushtet që nëpërmjet padisë të ngritur kundër këtyre vendimeve kërkuesi Mark Molla ka kërkuar edhe dëmshpërblimin e dëmit që mund të pësojë si rrjedhojë e zbatimit të këtyre vendimeve. Nisur sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Mark Molla për sigurimin e objektit të padisë është e bazuar në ligj dhe në akte dhe si e tillë ajo duhet pranuar.”*

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër konstaton se me kërkesëpadinë e ngritur nga paditësi Mark Molla në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 19.07.2022, në objektin e saj është kërkuar pavlefshmëria e vendimeve me numër 16 dhe 17 datë 18.07.2022 të lëshuara nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. .

Me vendimin me numër 16, datë 18.07.2022 të kryetarit Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Bardh Spahia është vendosur:

- 1. Lirimin nga detyra e e z. Mark Molla, administrator i shoqërisë aksionare “Ujësjiellës Kanalizime shkodër sh.a.” për shkak të mbarrimit të mandatit, sipas nenit 18, pika 5 e V.K.B. Shkodër me numër 28, datë 01.06.2016.*

Thelbi i kësaj kërkesëpadie është deklarimi i pavlefshmërisë së këtij vendimi dhe për pasojë rikthimi i paditësit Mark Molla në detyrën e administratorit të shoqërisë aksionare “Ujësjiellës Kanalizime shkodër sh.a.”.

Në kërkesën për sigurimin e padisë, objekt gjykimi, kërkohet pezullimi i vendimit nr. 16 datë 18.07.2022 të marrë nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. .

Me fjalë të tjera kërkohet rikthimi i kërkuesit Mark Molla në detyrën e administratorit të shoqërisë aksionare “Ujësjiellës Kanalizime shkodër sh.a.”, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes së themelit në gjykatën e apelit.

Kjo situatë është e ngjashme me atë për të cilën Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar, kur kanë marrë vendimin unifikues nr. 10, të vitit 2004, ku kanë arritur në përfundimin:

*“Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohëshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohëshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërkimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.”*

Ndodhur çështja në këto rrethana, trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër çmon se duhet të ndryshohet vendimi, me të cilin është pranuar kërkesa e kërkuesit Mark Molla për sigurimin e padisë dhe të rrëzohet kjo kërkesë.

**PËR KËTO ARSYE**

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër, bazuar në nenet 209 e 466/b të Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI**

Ndryshimin e vendimit nr. 16 (2984), datë 19.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e nesërmyja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

**Shkodër, më 26.10.2022.**

**ANËTAR**  
**TONIN STERKAJ**  
d.v

**ANËTARE**  
**VALBONA VATA**  
d.v

**RELATOR**  
**FUAT VJERDHA**  
d.v

Vërtetohet njësjë me origjinalin  
**KRYESEKRETARE**  
**Mimoza NDOCI**

